

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, (HUAMARRËSI), FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT), DHE KFW FRANKFURT AM MAIN (KFW), PËR PROGRAMIN E FURNIZIMIT ME UJË TË ZONAVE RURALE IV”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes së huas, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e huamarrësit, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit të furnizimit me ujë të zonave rurale IV.

Marrëveshja e huas ka për qëllim financimin e fazës së katërt të programit të furnizimit me ujë të zonave rurale, nëpërmjet akordimit nga KfW-ja të një huaje në shumën 40 000 000 (dyzet milionë) euro. Fondet e huas prej 40 milionë eurosh do të përdoren ekskluzivisht për rehabilitimin dhe shtrirjen e sistemeve të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe për shërbimet e konsulencës në lidhje me zbatimin e projektit.

Faza e katërt e programit të furnizimit me ujë të zonave rurale do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit, në vijim të fazave të implementuara më herët, përkatësisht faza e parë, e dytë dhe e tretë.

Investimet e fazës së katërt të programit të furnizimit me ujë të zonave rurale do të shtrihen në një zonë projekti që përfshin zonën bregdetare të jugut të Shqipërisë, duke u fokusuar në Bashkinë e Himarës dhe Bashkinë e Vlorës me fokus njësinë administrative Oriktum. Detajet e projektit, pajisjet dhe shërbimet që do të financohen nga fondet e huas do të rregullohen nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, e cila do të lidhet ndërmjet agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së dhe do të kundërfirmoset nga ana e huamarrësit, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në bazë të marrëveshjes fondet e huas mund të disbursohen deri në datën 30.3.2024.

Projekti ka si objektiv përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellësve dhe të kanalizimeve, nëpërmjet sigurimit të aksesit të qëndrueshëm në furnizimin me ujë të pijshëm për popullsinë permanente dhe turistët në zonën e projektit, me kosto sociale të pranueshme dhe tarifa që i mbulojnë kostot, si dhe sanitete të përshtatshme nëpërmjet sistemit të kanalizimeve, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe përmirësimin të kapaciteteve menaxhuese.

Zbatimi i këtij projekti do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe do të promovojë zhvillimin e turizmit në zonën e projektit, duke e çuar numrin e përfituesve në 80 000, përfshirë turistët.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Programi i furnizimit me ujë të zonave rurale IV i përgjigjet prioritetëve dhe qëllimeve të vëna për zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithashtu, ky program mbështetet në Strategjinë Kombëtare për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020.

Projektligji nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Shqipëria po përballlet me sfida në lidhje me sigurimin e cilësisë së sistemeve të furnizimit me ujë dhe të shërbimeve të kanalizimit ndaj qytetarëve. Pavarësisht progresit të vërejtur në vitet e fundit, menaxhimi i ujit dhe i kanalizimeve mbetet në një nivel të pakënaqshëm. Aksesit i pamjaftueshëm në ujë higjienikisht të pastër dhe mungesa e shërbimeve të kanalizimit përbëjnë problematikat infrastrukturore kryesore në zonat rurale.

Qeveria shqiptare, me mbështetjen ndërkombëtare, është duke trajtuar këto çështje nëpërmjet programeve të furnizimit me ujë të zonave rurale, përkatësisht fazës së parë, të dytë, të tretë dhe së fundi me fazën e katërt.

Me gjithë identifikimin më herët të nevojës së konsiderueshme për investime në qytetin e Himarës dhe në fshatrat fqinjë dhe në zonën e Orikumit, për shkak të fondeve të limituara, përfshirja e tyre në fazën e tretë nuk u bë e mundur. Kjo është arsyeja pse investimet e nevojshme në Himarë dhe në fshatrat e saj

bregdetare dhe Orikum do të realizohen në kuadër të fazës së katërt të programit të furnizimit me ujë të zonave rurale.

Për arsyet e përmendura më sipër, programi “Ujësjiellësat rurale IV” do të zbatohet në një zonë projekti e cila përfshin Bashkinë Himarë, ku futen qyteti i Himarës dhe fshatrat Kuç, Buronjë (afër Kuç), Pilur, Kudhës, Vuno, Jalë, Livadhi, Borsh, Himara Fshat, Qeparo si dhe në njësinë administrative Orikum të Bashkisë Vlorë. Qeveria shqiptare është e interesuar që të zhvillojë koncepte afatgjata për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe të infrastrukturës së kanalizimeve për të gjithë hapësirën e bashkive Himarë dhe Vlorë, me fokus brezin bregdetar. Për këtë arsye, është ndërmarrë edhe një studim fizibiliteti i financuar nga qeveria gjermane, që ka përfunduar në dhjetor 2018, për Bashkinë Himarë dhe një studim fizibiliteti për njësinë administrative Orikum, i përfunduar në shkurt 2019 dhe në bazë të të cilit do të kryhen investimet e planifikuara për t’u realizuar në bashkitë e sipërpërmendura. Studimet e fizibilitetit përshijnë edhe një raport për impaktin mjedisor dhe social të projektit, i cili do të detajohet më mirë gjatë përgatitjes së projektit.

Bashkia e Himarës, përfshirë edhe njësinë administrative Orikum në Bashkinë Vlorë, konsiderohen ndër rajonet më të rëndësishme turistike në Shqipëri, me një potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm. Gjendet në bregdetin jonian të Shqipërisë, rreth 140 km juglindje të Tiranës dhe kufizohet në veri me Vlorën dhe në jug me Sarandën. Popullësia totale e Bashkisë së Himarës është rreth 25 200 banorë, ndërkohë që numri i turistëve gjatë muajve të verës është 20 000 me disa projeksione shkon deri në 115 000 banorë në vitin 2025.

Problematikat që hasen në zonën bregdetare të Himarës dhe Orikumit janë të lidhura me faktin se ndërtimi i sistemeve të ujësjiellësve të Himarës datojnë që në vitin 1964. Sistemet ekzistuese të furnizimit me ujë konsistojnë në rrjete të vjetra që shkaktojnë humbje të ujit në shkallë të madhe dhe në puse me një kapacitet të pamjaftueshëm për kërkesën gjithmonë e në rritje veçanërisht gjatë pikut të sezonit veror. Sistemet e kanalizimeve nuk mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të zonës dhe janë të amortizuara. Për sa u përket sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotura në zonën e Himarës nuk ka, ndërsa në zonën e Orikumit duhet të vendosen në funksion. Duke pasur parasysh potencialin turistik të këtyre zonave, sensibilitetin e tyre dhe emergjencën për të ndërhyrë, lind nevoja për investime.

Huaja prej 40 milionë eurosh do të përdoret për të bashkëfinancuar fazën e katërt të programit për furnizimin me ujë të zonave rurale me një kosto totale prej 45.15 milionë eurosh, duke synuar kështu zgjidhjen e gjithë problematikës të parashtruar më sipër.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin nr.293, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, është nënshkruar ndërmjet palëve dhe po i nënshtrohet procedurës që parashikon kuadri ligjor në fuqi për bërjen efektive të marrëveshjeve ndërkombëtare. Konkretisht, bazuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të nenit 121, të Kushtetutës, në kushtet ku marrëveshja konsiston në marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë, marrëveshja duhet të ratifikohet me ligj.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes së huas, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e huamarrësit, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së, Frankfurt Am Main, për financimin e programit të furnizimit me ujë të zonave rurale IV, përmes akordimit të një huaje deri në vlerën 40 milionë euro.

Marrëveshja e huas ka për qëllim financimin e fazës së katërt të programit të furnizimit me ujë të zonave rurale, nëpërmjet akordimit nga KfW-ja të një huaje në shumën 40 000 000 (dyzet milionë) euro. Fondet e huas prej 40 milionë eurosh do të përdoren ekskluzivisht për rehabilitimin dhe shtrirjen e sistemeve të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe për shërbimet e konsulencës në lidhje me zbatimin e projektit.

Faza e katërt e programit të furnizimit me ujë të zonave rurale do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit, në vijim të fazave të implementuara më herët, përkatësisht faza e parë, e dytë dhe e tretë.

Investimet e fazës së katërt të programit të furnizimit me ujë të zonave rurale do të shtrihen në një zonë projekti që përfshin zonën bregdetare të jugut të

Shqipërisë, duke u fokusuar në Bashkinë e Himarës dhe Bashkinë e Vlorës me fokus njësinë administrative Orikum. Detajet e projektit, pajisjet dhe shërbimet që do të financohen nga fondet e huas, do të rregullohen nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, e cila do të lidhet ndërmjet agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së dhe do të kundërfirmoset nga ana e huamarrësit, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në bazë të marrëveshjes fondet e huas mund të disbursohen deri në datën 30.3.2024.

Projekti ka si objektiv përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellësve dhe të kanalizimeve, nëpërmjet sigurimit të aksesit të qëndrueshëm në furnizimin me ujë të pijshëm për popullësinë permanente dhe turistët në zonën e projektit, me kosto sociale të pranueshme dhe tarifa që i mbulojnë kostot, si dhe sanitete të përshtatshme nëpërmjet sistemit të kanalizimeve, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe përmirësimit të kapaciteteve menaxhuese.

Zbatimi i këtij projekti do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe do të promovojë zhvillimin e turizmit në zonën e projektit, duke e çuar numrin e përfituesve në 80 000, përfshirë turistët.

Marrëveshja e huas i bashkëlidhet projektligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e projektligjit. Programi do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji i propozuar është hartuar si rezultat i bashkëpunimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Huaja që do të akordohet nga KfW-ja është deri në vlerën prej 40 000 000 (dyzet milionë) eurosh, me termat e mëposhtëm financiarë të dakordësuar në marrëveshje:

-Shuma e huas: 40 000 000 euro;

-Interesi:	Normë fikse e interesit që përcaktohet në momentin e bërjes efektive të huas;
-Tarifa e menaxhimit:	1% e shumës së huas;
-Tarifa e angazhimit:	0.25% në vit, që llogaritet mbi shumën e padisbursuar të huas;
-Maturimi:	15 vjet, duke përfshirë periudhën prej 3 vitesh pa pagesë principali.

Norma e interesit të huas nuk përcaktohet në marrëveshje, por është dakordësuar në marrëveshje se kjo normë do të përcaktohet nga KfW-ja dy ditë pune nga marrja e njoftimit tonë se janë përmbushur kushtet e bërjes efektive të marrëveshjes së huas. Ky është një kusht i vendosur nga KfW-ja, pasi derisa kredia të bëhet efektive dhe të konsiderohet kredi e angazhuar për vendin tonë, nuk ka një bazë ligjore për KfW-në për të përcaktuar normën e interesit.

KfW-ja është një institucion i vlerësuar maksimalisht (AAA) nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit të riskut dhe, si e tillë, ajo mundëson refinancimin e kredive me kushte shumë të favorshme në tregun e kapitaleve.

Në marrëveshjen qeveritare që do të lidhet, ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (ku të dyja qeveritë bien dakord për bashkëpunimin financiar për programin në fjalë), ndër të tjera parashikohet se qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau* (KfW) një kredi të butë në vlerë të përgjithshme deri në 40 000 000 euro, e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim për zbatimin e projektit “Furnizimi me ujë i zonave rurale IV”. Në këto kushte, mundësohet që termat e favorshëm të përfitimit të fondeve nga KfW-ja, (mbështetur në instrumentin e subvencionimit të interesit nga qeveria gjermane, si dhe fondeve të vëna në dispozicion nga kjo e fundit për projektin në fjalë) t’i transmetohen vendit tonë.

Gjithashtu, në lidhje me kreditë për zhvillim që akordon KfW-ja, raporton pranë OECD-së, ku kreditë duhet t’i përmbahen një sërë kriteresh për t’u konsideruar si kredi ndihmë për zhvillim (ODA). Një nga kriteret më të rëndësishme është elementi grant i këtyre kredive (*grant element*), ku ky element duhet të jetë së paku në nivelin prej 10% për vende me të ardhura mbi mesataren (siç është klasifikuar vendi ynë nga Banka Botërore).

Nga pikëpamja historike e bashkëpunimit me KfW-në, si një partner i besueshëm zhvillimi, kryesisht kreditë e akorduara nga kjo e fundit në dhjetë vitet e fundit kanë pasur norma interesi të fiksuara në nivelin prej rreth 1-2% ku mënyra e përcaktimit të normës së interesit ka qenë po njëjloj si kredia e

propozuar, pra pas momentit të bërjes efektive të huas. Këto lloj normash, krahasuar me instrumentin më afatgjatë të huas që ka vendi ynë në tregun ndërkombëtar (*Eurobondi 2018*), janë rreth tre herë më të ulëta, kjo duke marrë parasysh për më tepër që edhe afati i maturimit të huas së KfW-së është më i gjatë sesa afati i Eurobondit.

Edhe për huan që synohet të përfitohet me anë të kësaj marrëveshjeje, parashikohet që norma të jetë poshtë nivelit prej 2%. Konkretisht, në ditën e negociimit të marrëveshjes së huas, norma indikative e interesit ishte 1.1%. KfW-ja është e gatshme të sigurojë informacion mbi normën e interesit në çdo kohë (me një kërkesë paraprake drejtuar dy ditë para).

Kostoja totale e projektit “Furnizimi me ujë i zonave rurale IV” vlerësohet të jetë 45.15 milionë euro (pa përfshirë këtu vlerën e TVSH-së apo taksa të tjera që lindin nga projekti që do të mbulohen nga buxheti i FSHZ-së), kosto e cila do të financohet nga:

- huaja në fjalë në vlerën prej 40 milionë euro;
- buxheti i shtetit në vlerën 1.35 milionë euro;
- granti që do të akordohet nga KfW-ja në vlerën 2 milionë euro;
- granti që do të akordohet nga WBIF-ja në vlerën 1.8 milionë euro.

Projekti është parashikuar në programin buxhetor afatmesëm 2019-2021 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, më konkretisht në programin “Furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

KËSHILLI I MINISTRAVE